

URDHËR
Nr. 643, datë 28.10.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Autorizimin e Sekretarit të Përgjithshëm, z. Erzen Tola, për të nënshkruar autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në emër të nëpunësit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha gjykatat dhe shkallët e gjykimit, si dhe aktet, duke përfshirë dhe pa u kufizuar, kërkesëpadi, kërkesë penale, kallëzime penale, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të çështjeve, si dhe t’i nënshkruajë ato.

2. Data e fillimit të kompetencave të deleguara është data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi